



Republika e Kosovës // Republika Kosova // Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



DREJTORIA E ARSIMIT

Nr. 05/326

Dt. 26.07.2022

Bazuar në nenin 8 të Ligjit të Punës nr.03/L-212 të Republikës së Kosovës, Udhëzimit Administrativ(MPMS) Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik të datës 19.10.2017, Drejtoria e Arsimit, shpall:

K O N K U R S

PËR PLOTËSIMIN E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

Titulli i vendit të punës: Punëtor teknik

Institucioni: SHFMU “Naum Veqilharxhi”

Vendi: Llapashticë e Epërme

Numri i pozitave: 1 (një)

Orari i punës: 40 orë në javë

Data e njoftimit: 26/07/2022 - 24.08.2022 (<https://konkursi.rks-gov.net>)

Afati për aplikim: 25/08/2022 - 08/09/2022

Detyrat kryesore të punës:

- Të pastrojë dhe mirëmbajë të gjitha mjediset e shkollës, të mirëmbajë sipërfaqet e gjelbëruara të shkollës;
- Të ruaj mirë pasurinë e institucionit edukativo-arsimor dhe ta përdorë atë me kujdes;
- Të identifikojë, të evidentojë, të llogarisë dhe të planifikojë në afate periodike, të caktuara nga drejtori, shpenzimet që krijohen me amortizimin ose harxhimin e mjeteve të punës;
- Të mirëmbajë objektin, të kujdeset për shpenzimet e lendeve djegëse, ruajtjen e pajisjeve për mirëmbajtje të higjienës dhe sipas nevojës, t’ia prezantojë drejtorit planifikimin e përgjithshëm të shpenzimeve të institucionit edukativo-arsimor për çështjen e higjienës;
- Të përkujdeset për rregullimin, mirëmbajtjen e inventarit të shkollës dhe për rregullimin e prishjeve teknike në objektin e shkollës;
- Kryen edhe detyra të tjera, të caktuara nga drejtori i shkollës.

Kushtet:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të kenë të kryer arsimin e mesëm.

Dokumentet që duhet të dorëzohen për aplikim:

- Formulari i aplikimit i cili merret dhe dorëzohet në Zyrën për Shërbime me Qytetarë;
- Certifikata e lindjes;
- Dokumenti personal – letërnjoftimi ose pasaporta (kopje);

- Dëshmi mbi kualifikimin;
- Dëshmi që nuk jeni të ndjekur penalisht;
- Certifikatën e mjekut (vetëm kandidatet të cilët pranojnë pas publikimit të rezultateve).

Afati i konkursit

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë kalendarike nga dita e shpalljes, pra nga data: **25/08/2022** deri më **08/09/2022** dhe është i publikuar në portalin për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). në tabelën e shpalljeve në objektin e komunës dhe në web-faqen e Komunës së Podujevës: <http://kk.rks-gov.net/podujeve/>

Mënyra e aplikimit

Të gjithë kandidatët e interesuar, aplikacionet mund t'i marrin në formë fizike në Qendrën për Shërbime me Qytetarë, në portalin për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>) apo t'i shkarkojnë nga web faqja zyrtare e Komunës së Podujevës <http://kk.rks-gov.net/podujeve/> dhe të plotësuara t'i dorëzojnë në Qendrën për Shërbim me Qytetarë në Komunën e Podujevës.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranojnë dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret dhe hyjnë në listën e ngushtë do të ftohen në test me shkrim.

Për kohën dhe vendin e mbajtjes së testit dhe intervistave kandidatët do të informohen përmes njoftimeve të cilat do të publikohen në web faqen e Komunës së Podujevës dhe në tabelën e shpalljeve në objektin e komunës, pas mbylljes së konkursit.

Drejtori i DKA-së

Avni Fetahu

